

Kryetari i KLP-së, z.Gent Ibrahimi pret në takim Ministren e Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj

POSTED 18/09/2020 KLP



Sot në mesditë, kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë priti në takim punë ministren e Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj ku temë diskutimi ishte identifikimi dhe realizimi i disa objektivave në kuadër të axhendës së Komitetit Teknik Institucional, i cili pritet të mbledhet në muajt e ardhshëm dhe ku do të marrin pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve të drejtësisë në vend, misione ndërkombëtare të asistencës në fushën e zbatimit të reformës në drejtësisë dhe misione diplomatike të akredituara në vend.



Pasi falenderoi ministren Gjonaj për bashkëpunimin dhe koordinimin efikas midis të dy institucioneve për sa i përket bashkërendimit dhe raportimit të saktë të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, zoti Ibrahim informoi ministren Gjonaj për problematikat imediate me të cilat përballet Këshilli aktualisht; plotësimin e dy vakancave në Këshill, emërimin e drejtuesëve të prokurorive në vend pas miratimit nga ana e Këshillit të rregullores “Për ngritjen në detyrë në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë dhe përgatitja e opinionit nga ana e Këshillit për sa i përket amendimeve dhe ndryshimeve në ligjin për statusin e magjistratit. Gjithashtu, Kryetari i Këshillit nënvizoi nevojën e reformimit të procesit të hetimit dhe krijimin e një lidhjeje organike midis policisë gjyqësore dhe prokurorisë.



Ministrja Gjonaj përgëzoi zotin Ibrahimini për punën dhe rezultatet e arritura nga Këshilli deri tani dhe kërkoi përfshirjen aktive të tij në hartimin e hartës gjyqësore në vend ku një rol të rëndësishëm kanë prokuroritë të cilat do të kenë të garantuara funksionimin, administrimin dhe aksesin e qytetarëve në këto institucione.